



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

L ë n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 19.11.2020

Më datë 19 Nëntor u mbajt takimi i parë për vitin 2020 i Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat, KKN. Drejtori i përgjithshëm i Institutit të Statistikave, INSTAT, Znj. Elsa Dhuli përshëndeti anëtarët e KKN-së dhe prezantoi anëtarët e rinj të KKN-së, përfaqësues të INSTAT. Draft agjenda u diskutua dhe u miratua nga të gjithë anëtarët.

Takimi u ndoq online edhe nga anëtarë të Bordit Drejtues i INSTAT.

Në mbledhjen e radhës së KKN-së u diskutua:

1. Klasifikimi i produkteve sipas aktivitetit ekonomik, versioni 2.1 (CPAV 2.1);

Anëtarja e KKN-së pranë INSTAT Znj. Flutura Rama bëri një përshkrim të shkurtër të KKN-së në mënyrë që anëtarët e rinj të jenë më të familjarizuar me qëllimin e krijimit të këtij komisioni. Ndër të tjera ajo shtoi që KKN është organi i cili ka për detyrë të kryejë përditësimin dhe përshtatjen e klasifikimeve statistikore, ekonomike dhe sociale, në përputhje me klasifikimet statistikore evropiane dhe ndërkombëtare. KKN përbëhet nga përfaqësues të INSTAT-it, agjencie statistikore, ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera publike, të cilat përdorin dhe zbatojnë klasifikimet zyrtare, ekonomike dhe sociale. Klasifikimet janë ndërkombëtare dhe kombëtare. Klasifikimet ndërkombëtare funksionojnë si "gjuhë ndërkombëtare" për komunikim në statistika dhe detyra e këtij komisioni është që këto klasifikime ndërkombëtare ti kalojë në kombëtare pra t'i përshtasë me specifikat kombëtare duke i shtuar një nivel detajimi pa ndryshuar strukturën e miratuar më parë.

2. Prezantim mbi trajnimin e punonjësve të pushtetit lokal mbi klasifikimin e aktivitetit ekonomik, NVE Rev.2

Çështja e dytë në diskutim nga Znj.Rama ishin trajnimet për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të bashkisë.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Gjatë vitit 2020 punonjësit e bashkive u trajnuan për klasifikimin e aktivitetit ekonomik, NVE Rev.2. Për shkak të situatës së Covid-19 trajnimi u zhvillua në 6 ditë të ndryshme dhe pjesmarrës në trajnim ishin punjës nga të 61 bashkitë. Pjesa më e madhe e stafit të bashkive ishin gra.

3. Nomenklatura ndërkombëtare e krimeve për qëllime statistikore (ICCS) - prezantim i 4 kapitujve të parë të përkthyer në gjuhën shqipe

Znj. Majlinda Nesturi, drejtor në Drejtorinë e Statistikave Sociale pranë INSTAT, gjithashtu përgjegjëse për klasifikim e krimeve për qëllime statistikore (ICCS) dha një informacion më të detajuar të këtij klasifikimi. Ky klasifikim është zhvilluar nga zyra e kombeve të bashkuara për drogën dhe krimin (UNODC). ICCS është një klasifikim që grupon dhe organizon veprat penale në mënyrë hierarkike dhe sistematike. Objekti i klasifikimit ose njësia primare e klasifikimit është vepra ose ngjarja që përbën një vepër penale dhe jo një dispozitë ligjore. Rëndësia e këtij klasifikimi është pikërisht standartizimi ndërkombëtar i statistikave të krimeve, krahasueshmëria midis vendeve dhe me kalimin e kohës krahasueshmëria midis burimeve ndryshme. Klasifikimi siguron një strukturë të përbashkët për prodhimin e të dhënave të krimeve në të gjitha institucionet e drejtësisë penale dhe gjithashtu ofron analiza analitike për të dhënat statistikore.

4. Nomenklatura e shteteve dhe e territorit për statistikave evropiane mbi tregtinë ndërkombëtare të mallrave- materiali draft për miratim nga KKN

Në vijim fjalën e mori Z. Elton Aliko drejtor i Drejtorisë së Statistikave Reale pranë INSTAT, i cili shpjegoi se nomenklatura (klasifikimi) e shteteve dhe territoreve në tregtinë e jashtme e njohur ndryshe edhe Geonomenklatura shërben për grumbullimin (mbledhjen) dhe shpërndarjen e statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave sipas vendeve me të cilët kryen tregtinë e mallrave. Kjo nomenklaturë përdoret kryesisht nga vendet e BE për grumbullimin dhe shpërndarjen e statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave brenda shteteve të BE dhe me vendet e tjera të botës. Ky klasifikim është një kërkesë nga BE për t'u ndërtuar.

5. Diskutime të tjera

- Nomenklatura e arsimit, ISCED.
- Rregullorja e KKN-së.

Përgatiti:

Sekretariati i KKN

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al